

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA КЕШИЛИТ ПРОКУРОРИАЛ И КОСОВËС - ТУЗЛАКЦИ САВЕТ КОСОВË SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT ARKIVA - ARHIVA		
Pranuar 29 -01- 2020 Priljeno		
Numri rëndor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkimi i pranuesit Potpis primaoca
102		

AA.nr. 33/2019

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gyltene Sylejmani, kryetere, Erdogan Haxhibeqiri dhe Jelena Krivokapiq, antarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj Ruhan Salihu, prokuror në Prokurorin Themelore në Prishtinë, kundër Këshillit Prokurorial i Kosovës, për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së prokurorit Ruhan Salihu, paraqitur kundër Vendimit Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 729/2019 datë 12 nëntor 2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.01.2020 morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pa themeltë ankesa e prokurorit Ruhan Salihu, Prokuror në Prokurorin Themelore në Prishtinë, dhe vërtetohet Vendimi i Këshillit Prokurorial i Kosovës, KPK/Nr. 729/2019 datë 12 nëntor 2019.

A r s y e t i m

Me pjesën I të Vendimit, të Këshillit Prokuroria të Kosovës, KPK/Nr. 729/2019 datë 12 nëntor 2019, aprovohet si i bazuar Raporti i Penalit hetimor AD.nr.18/2009, i datës 11 tetor 2019, lidhur me prokurorin Ruhan Salihu, Prokuror në Prokurorin Themelore në Prishtinë-Departamenti për të mitur. Me pjesën II të dispozitivit, vërtetohet se te prokurori Ruhan Salihu, janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, që bien ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, dhe në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Me pjesën III të dispozitivit, prokurorit Ruhan Salihu, i shqiptohet masa disiplinore "Zvogëlim i përkohshëm i pagës në tridhjetë përqind 30% për një periudhë kohore gjashtë (6) muaj" në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij Vendimi prokurorit Ruhan Salihu në afat ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi masën disiplinore, me propozim që Vendimi mbi shqiptimin e masës disiplinore të ndryshohet në favor të tij, ose eventualisht ti shqiptohet ndonjë masë më e lehtë siç janë vërejtje jo publike me shkrim ose vërejtje publike me shkrim, duke marrë parasysh se asnjëherë deri më tani nuk ka pas masë disiplinore të shqiptuar dhe masa e shqiptuar nuk është në përputhje me parimet e proporcionalitetit duke u bazuar në punën e tij të deritanishme.

Përgjigje në ankesë ka parashtuar kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës, me propozim që ankesa e prokurorit Ruhan Salihu të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të ligjshmërinë së vendimit kontestues në vështrim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes ndaj ankesës, si dhe shkresat tjera të lëndës



dhe në bazë të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve , ka gjetur se :

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 29 korrik 2019, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Autoriteti Kompetent, ka pranuar propozimin për fillimin e procedurës hetimore disiplinore ndaj prokurorit Ruhan Salihu, duke propozuar që të hetohen veprimet e të njëjtit si dhe t'i shqiptohet sanksioni disiplinor në përputhje me nenin 7 paragrafi 1, pika 1.4 të ligjit të lartcekur.

Me vendimin nr. KPK/Nr.472/2019 të datës 01.08.2018, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka themeluar Panelin hetimor për hetimin e rastit disiplinor, AD.Nr.18/2019, ndaj prokurorit Ruhan Salihu, Prokuroria Themelore në Prishtinë, për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në seancën disiplinore të mbajtur më 12 nëntor 2019, ka shqyrtuar raportin e Panelit hetimor, AD.Nr.18/2019, lidhur me lëndën [REDAKTUAR] dhe vlerësimin të shkresave të tjera në dosjen e lëndës: deklaratën e dëshmitarit [REDAKTUAR] dhënë më datën 29.01.2019 në SP në [REDAKTUAR], deklaratën e dëshmitares-përfaqësueses ligjore të miturit [REDAKTUAR] e dhënë para pjesëmarrësve të policisë më datë 31.01.2019, deklaratën e të dyshuarit [REDAKTUAR], datë 04.04.2019, Raportin zyrtar të kontaktit të parë pas intervistimit të dyshuarit [REDAKTUAR] të policit hetues [REDAKTUAR] me Prokurorin Kujdestar Ruhan Salihu, i datës 04.04.2019, shënimi zyrtar i policisë hetuese lidhur me ekzaminimin mjeko ligjor, i datës 11.04.2019 dhe pas dëgjimit të prokurorit Ruhan Salihu, Paneli hetimor erdh në përfundim se në veprimet e prokurorit Ruhan Salihu janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, duke u nisur nga faktet jo kontestuese se prokurori është njoftuar nga polici hetues se pas shumë punëve operative është arrestuar i dyshuar [REDAKTUAR] dhe pas intervistimit ka pranuar se ka abuzuar seksualisht me të miturin [REDAKTUAR] prokurori ka udhëzuar që rasti të procedohet në mënyrë të rregullt duke mos kërkuar që i njëjti të ndalohej dhe të kërkohej masa paraburgimi. Po ashtu, nuk është urdhëruar që viktimës, tani të ndjerit, t'i bëhet ekzaminimi mjeko ligjor, që bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, me nenin 6, paragrafi 2, 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në seancën disiplinore prokurori Ruhan Salihu, ka pohuar se për këtë rast për herë të parë ka dëgjuar në kujdestarin e tij më datën 04.04.2019, përmes telefonit nga polici hetues i Stacionit Policor në [REDAKTUAR], për një person të komunitetit RAE, i cili është dyshuar për abuzim seksual me një fëmijë tjetër po ashtu të komunitetit RAE, gjithashtu nga hetuesi policor është njoftuar se i dyshuari ka pranuar se ka abuzuar me të dëmtuarin e mitur, dhe ka urdhëruar Policinë e Kosovës, që të hap rastin për veprën penale, keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 235, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, po ashtu prokurori në mbrojtjen e tij ka deklaruar se arsyeja që nuk ka urdhëruar ekzaminimin mjeko-ligjor të miturit të dëmtuar, ka qenë se abuzimi seksual dyshohet se është kryer para 4-5 muaj më parë, dhe ka qenë e pamundur të gjenden prova të mundshme biologjike, për këtë arsye, të dyshuarin nuk e kanë ndaluar dhe rastin e ka lënë në procedurë të rregullt.

Këshilli Prokuroria i Kosovës duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike ka vërtetuar në veprimet e prokurorit Ruhan Salihu janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore që bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror dhe me nenin 6, paragrafi 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Me Vendimin, KPK/Nr. 729/2019 datë 12 nëntor 2019, prokurorit Ruhan Salihu i shqiptoj sanksionin



disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës në 30% (tredhjet për qind) për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.3, të ligjit të lartcekur.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit të Pavarur të Kosovës, është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është i ligjshëm dhe është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës material kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore e prokurorit Ruhan Salihu për shkeljen e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror dhe nenit 6, paragrafi 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe vendimi përkitazi me masën e shqiptuar disiplinore të marrë për këto shkelje.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, vendimi i atakuar është mjaft i qartë dhe ka arsye bindëse për të gjitha faktet vendimtare lidhur me përgjegjësinë disiplinore të prokurorit Ruhan Salihu, kjo për faktin se, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, deklaratat e dëshmitarëve të përgatitura nga Paneli hetimor, deklaratat e parashtruesit të ankesës si dhe dëshmitë tjera të vlerësuara nga Këshilli i Pavarur i Kosovës, rezulton se, në veprimet e prokurorit, ka elemente të përgjegjësive disiplinore pasi që nga shkresat në lëndë rezulton se prokurori Ruhan Salihu, është njoftuar nga polici hetues, për rastin e abuzimit seksual të miturit [REDAKTUAR] se i arrestuari i dyshuar [REDAKTUAR] i cili pas intervistimit ka pranuar se ka abuzuar seksualisht me të miturin [REDAKTUAR] dhe përkundër këtij fakti ka urdhëruar që rasti të procedohet në mënyrë të rregullt duke mos kërkuar që i dyshuari [REDAKTUAR] të ndalohet dhe të kërkohet caktimi i masës së paraburgimit. Po ashtu, i njëjti nuk ka urdhëruar që viktimës tani të ndërjet [REDAKTUAR] t'i bëhet ekzaminimi mjeko ligjor për të konstatuar lëndimet eventuale trupore. Ky mos veprim i prokurorit drejt është vlerësuar nga ana e Këshillit Prokurorial i Kosovës se është në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror dhe me nenin 6 paragrafi 2 pika 2.1 të 3 Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Vendimi i atakuar ka mbështetje në provat e siguruar gjatë hetimeve nga Paneli hetimor të cilat prova nuk kanë qenë të kundërshtuara nga ana e prokurorit pasi që i njëjti së seancës dëgjimore në KPK, ka pranuar se nuk është tërësisht i papërgjegjshëm.

Prokurori Ruhan Salihu në këtë rast është dashur që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet brenda afateve kohore për të mos ardhur deri te rasti, t'i respektoj dhe t'u përmbahet parimeve të përcaktuar me Kodin e Etikës për Prokuror, që të nxisë besimin e publikut në dinjitet, integritet, efikasitet dhe paanshmëri në punën e tij. T'i kryej detyrat me paanshmëri dhe kujdes, të shmang çdo sjellje dhe situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetin dhe paanshmërinë, ta respektoj dhe t'i përmbahet ligjit, t'i kryejë detyrat e tij bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve të duhura brenda afateve kohore, në sjelljen e prokurorit ka elemente të shkeljes së Kodit të Etikës për Prokuror, ashtu si drejtë është vlerësuar në Vendimin kontestuese.

Prandaj, janë të papranueshme pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin jo të plot dhe të gabuar të gjendjes faktike me arsyetim se me asnjë prove nuk është vërtetuar se në veprimet e tij apo mos veprim të tij ka kontribuar që të vijë deri te ky rast, se nuk është njoftuar me shkrim gjegjësisht ka ndërmarrë të gjitha veprimet që është të ndërmerren dhe se në rastin konkret viktimat nuk është dërguar në ekzaminim mjekësor me arsyetim se të gjitha provat biologjike janë zhdukur për shkak se rasti kishte ndodhur 4-5 muaj më herët dhe se në kohën kur është njoftuar nuk ka pas asnjë provë të vetme se vërtetë ka ndodhur abuzimi pasi që nuk ka pasur të dëmtuar e të identifikuar e as të intervistuar në polici. Këto pretendime kanë qenë objekt i vlerësimit i Këshillit të Pavarur i Kosovës dhe si të tilla janë të papranueshme edhe për këtë Gjykatë pasi që janë në kundërshtim me provat tjera që gjenden në lëndë pasi që vetë prokurori



në deklaratën e tij gjatë mbajtjes së seancës dëgjimore në KPK ka pohuar se ka qenë i njoftuar lidhur me rastin edhe sa i përket moshës dhe gjinisë së të dëmtuarit.

Pretendimet ngritura në ankesë se ai nuk ka pasur provë të vetme se vërtetë ka ndodhur abuzimi pasi që nuk ka pasur të dëmtuar e të identifikuar e as të intervistuar në polici, janë në kundërshtim me shkresat e lëndisë. Në shkresat e lëndës gjendet deklarata e dhënë në polici lidhur me rastin që ka paraqitur prindi i tani i të pandehurit si deklarata e dhënë nga nëna e viktimës, tani të ndjeri [REDACTED] të cilët kanë pohuar se ka ndodhur abuzimi seksual po ashtu edhe vetë i pandehuri në deklaratën e tij të dhënë në polici ka pranuar se ka abuzuar seksualisht me tani të ndjerin që ka qenë i identifikuar.

Po ashtu masat disiplinore e shqiptuar është i ligjshëm dhe në përputhje me nenit 7 paragrafi 1 pika 1.3, Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga prokurori, pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; performancën dhe sjelljen e përgjithshme të prokurorit; sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të prokurorit gjatë procedurës disiplinore. Rrjedhimisht, sanksioni disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor, i cili sanksion do të ketë efekt pozitiv për ashtu që i njëjti në të ardhmen të veproj konform Rregullave të Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për prokuror. Prandaj, parashtimet në ankesë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara.

Nga sa u tha në ankesë e në pajtim me nenin 15.6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
AA.nr. 33/20-19, më 09.01.2020

Kryetare e kolegjit
Gyltene Sylejmani



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTEJES
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
